



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 289/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Malishevë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetvendosje (LVV) dega në Malishevë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega në Malishevë, me të cilën pretendohet se me datë 08.06.2014, rreth orës 08:30, në Qendrën e Votimit 3046/1 fshati Turjakë, KK Malishevë, nga kryesuesi i kësaj qendre Pajtim Zogaj nga subjekti politik AAK, ishte lejuar që personi i identifikuar Arben Bytyqi që të votoj pa dokument valid në kundërshtim me ligjin mbi zgjedhjet.

Me tutje në ankesë theksohet se komisioneri nga Lëvizja Vetëvendosje, Hastretlind Zogaj, ka tentuar ta pengojë këtë parregullsi por nuk ka mundur ta ndaloj, kështu që për këtë rast është shënuar në librin e parregullsisë dhe është njoftuar KKZ si dhe Policia në këtë qendër, zyrtari policor Fatmir Krasniqi, Stacioni Policor në Malishevë. Në vendin e ngjarjes ku është supozur se ka ndodhur kjo parregullsi ka shkuar edhe anëtarë i Lëvizjes Vetëvendosje në KKZ, Valon Hoti i cili është njoftuar për këtë rast dhe e ka konfirmuar rastin.

LVV pretendon se me këtë veprim kryesuesi Pajtim Zogaj nga subjekti politik AAK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Nenit 16 të Rregullës Zgjedhore 09/2013 të KQZ-së. Me tutje LVV thekson se me këtë veprim ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti të ketë kryer veprën penale nga Neni 409 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe veprën penale nga Neni 422 paragrafi.2 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga Kodi Penal i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratat e dëshmitarëve: Valon Hoti-KKZ, Hastretlind Zogaj-Komisioneri i VV-së. Parashtruesi i ankesës propozon që ndaj subjektit politik të lartë përmendur të ndërmerren masa ligjore në pajtim me LZP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 10.06.2014 e informoi subjektin politik AAK, për ankesën që është kundër këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AAK, me të cilën theksohet se AAK-ja deklaron se pershkrimi i ankesës në fjalë duhet te trajtohet nga prokuroria e shtetit, sipas tyre AAK gjithmonë ka bërë thirrje publike per respektimin e rregullave dhe ligjeve ne fuqi. Me tutje ne pergjigjen ne ankese nga AAK-ja theksohet se në qoftë se personi në fjalë ka bërë një shkelje te ligjit apo rregullave atëherë subjekti politik është në pajtim që i njejt i të përgjigjet. Bashkangjitur ne përgjigjen në ankesë është edhe Udhëzimi i Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e Rregullave dhe Ligjin për Zgjedhjet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën si dhe shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës, se pretendimet ankimore që personi në fjalë ka votuar pa dokument valid, nuk qendërojnë ngase nuk është argumentuar me asnjë provë materiale nga pala ankuese për t'i vërtetuar pretendimet e tilla. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar sipas nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 289/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*